

GJËRAT KRYESORE QË DUHET TË DINI PËR VAKSINAT KUNDËR COVID-19¹

GJËRAT KRYESORE QË DUHET TË DINI

Vaksinat COVID-19 janë të sigurta dhe efektive.

Mund të keni efekte anësore pas vaksinimit, por këto janë normale.

Vaksinimi kundër COVID-19 do t'ju ndihmojë të mbroheni nga infektimi me COVID-19. Ju mund të keni disa efekte anësore, të cilat janë shenja normale që trupi juaj po ndërton mbrojtje. Këto efekte anësore mund të ndikojnë në aftësinë tuaj për të bërë aktivitete të përditshme, por ato duhet të zbehen për disa ditë. Disa njerëz nuk kanë asnjë efekt anësor.

DISA NGA EFEKTET ANËSORE KUR VAKSINOHENI

Në krahun ku keni bërë injeksionin e vaksinës, mund të keni:

- Dhimbje
- Skuqje
- Ënjtje

Në të gjithë pjesën tjetër të trupit tuaj, mund të keni:

- Lodhje
- Dhimbje koke
- Dhimbje muskulore
- Të dridhura
- Ethe
- Të përziera

KËSHILLA TË DOBISHME

Flisni me mjekun tuaj për marrjen e ilaçeve pa recetë, të tilla si ibuprofen, acetaminofen, aspirinë ose antihistaminë, për çdo dhimbje dhe shqetësim që mund të përjetoni pasi të vaksinoheni. Ju mund t'i merrni këto ilaçe për të lehtësuar efektet anësore pas vaksinimit, gjithmonë nëse nuk keni ndonjë arsye tjetër mjekësore që ju pengon të merrni këto ilaçe. Nuk rekomandohet të merrni këto ilaçe para vaksinimit me qëllim që të përpiqeni të parandaloni efektet anësore.

Për të zvogëluar dhimbjen dhe shqetësimin në krahun ku keni bërë injeksionin e vaksinës, ju mund të:

- Vendosni një leckë të pastër, të freskët dhe të lagur mbi zonën ku është bërë injeksioni i vaksinës.
- Përdorni ose ushtroni krahun tuaj.

Për të zvogëluar shqetësimin nga temperatura, ju mund të:

- Pini shumë lëngje.
- Visheni lehtë.

¹ <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/vaccines/expect/after.html>

Nëse keni marrë dozën e dytë:

Efektet anësore pas marrjes së dozës tuaj të dytë të vaksinës, mund të jenë më intensive sesa ato që keni përjetuar pas dozës së parë të vaksinës. Këto efekte anësore janë shenja normale që trupi juaj po ndërton mbrojtje dhe duhet të zbehen brenda disa ditësh.

Kur duhet të telefononi mjekun

Në shumicën e rasteve, shqetësimi nga dhimbja ose temperatura është një shenjë normale që trupi juaj po ndërton mbrojtje.

Kontaktimi mjekun tuaj ose ofruesin e kujdesit shëndetësor nëse:

- Skuqja ose ndjeshmëria aty ku keni bërë injeksionin e vaksinës përkeqësohen pas 24 orësh
- Efektet tuaja anësore po ju shqetësojnë në mënyrë serioze ose nuk duket se po zbehen pas disa ditësh

NËSE MERRNI NJË VAKSINË COVID-19 DHE MENDONI SE MUND TË KENI NJË REAKSION TË RËNDË ALERGJIK PASI TË KENI LËNË VENDIN E VAKSINIT, KËRKONI KUJDES TË MENJËHERSHËM MJEKËSOR DUKE TELEFONUAR NË 127.

- Zakonisht duhen dy javë pasi jeni vaksinuar, që trupi të ndërtojë mbrojtje (imunitet) kundër virusit që shkakton COVID-19.
- Marrja e një vaccine COVID-19 do t'ju ndihmojë gjithashtu të mos sëmurëni rëndë edhe nëse infektoheni me COVID-19.
- Vaksinat po bëhen të disponueshme gjerësisht, muaj pas muaji.
- Njerëzit të cilët janë vaksinuar plotësisht mund të fillojnë të bëjnë disa gjëra që ata kishin ndaluar të bënin për shkak të pandemisë.

MOS HARRONI

- Efektet anësore mund të ndikojnë në aftësinë tuaj për të bërë aktivitete të përditshme, por ato duhet të zbehen për disa ditë.
- Vakcina Pfizer-BioNTech COVID-19 dhe Moderna COVID-19, të dyja kanë nevojë për 2 doza, në mënyrë që të merrni sa më shumë mbrojtje. Duhet të bëni dozën e dytë edhe nëse keni efekte anësore pas dozës së parë, përveç nëse një ofrues i vaksinimit ose mjeku juaj ju thotë të mos e merrni.
- Ju duhet vetëm 1 dozë e vaksinës Johnson & Johnson's Janssen (J & J / Janssen) COVID-19 për të marrë sa më shumë mbrojtje.
- Duhet kohë që trupi juaj të krijojë mbrojtje pas çdo vaksinimi. Njerëzit konsiderohen të vaksinuar plotësisht dy javë pas injektimit të dozës dytë të vaksinës Pfizer-BioNTech ose Moderna COVID-19, ose dy javë pas vaksinës me një dozë të vetme J & J / Janssen COVID-19. Ju duhet të vazhdoni të përdorni të gjitha mjetet në dispozicion për të mbrojtur veten dhe të tjerët derisa të vaksinoheni plotësisht.
- Pasi të jeni vaksinuar plotësisht kundër COVID-19, mund të jeni në gjendje të filloni të bëni disa gjëra që keni së bërë, për shkak të pandemisë.
- Ne jemi ende duke mësuar se si vaksinat do të ndikojnë në përhapjen e COVID-19. Pasi të jeni vaksinuar plotësisht kundër COVID-19, duhet të vazhdoni të merrni masa paraprake në vende publike si p.sh. të mbani një maskë, të qëndroni 2 metra larg të tjerëve, të shmangni turmat dhe hapësirat pak të ajrosura si dhe të lani duart shpesh. QKPS² do të vazhdojë të azhurnojë rekomandimet.

ÇFARË JEMI DUKE MËSUAR AKOMA?

- Ne jemi ende duke mësuar se sa vaksinat parandalojnë përhapjen e virusit që shkakton COVID-19, tek të tjerët, edhe nëse nuk keni simptoma.
- Ne jemi gjithashtu duke mësuar se për sa kohë vaksinat COVID-19 mbrojnë njerëzit.
- Ne jemi ende duke mësuar se sa njerëz duhet të vaksinohen kundër COVID-19, para se shumica e njerëzve të konsiderohen të mbrojtur (imuniteti i popullsisë).
- Ne jemi akoma duke mësuar se sa efektive janë vaksinat ndaj varianteve të reja të virusit që shkakton COVID-19.

² Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve

Ky dokument është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në kuadrin e projektit " COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar", të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë : <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.